



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN

Nr. _____ Prot

Polican, me ____ .06.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Pastrimi Dhe Mirembajtja E Kanalit Vadites Te Disa Fshaterave
Njesia Administrative Vertop, Bashkia Polican"**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Shërbime të pastrimit të kanaleve 90641000-2**

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 1 594 905 (nje milion e peseqind e nentëdhjetë e katër mijë e nentëqind e pesë leke) **Monedhaleke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin 16/2024, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Polican, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP ndryshuar me ligjin 16/2024, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteret e mesipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 10 ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP ndryshuar me ligjin 16/2024, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe shtojcës 10 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare , 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.** (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP ndryshuar me ligjin 16/2024, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues për gatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore **brenda datës 31 mars të vitit pasardhës***".

2.2. 2Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP ndryshuar me ligjin 16/2024, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, nën 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, ndryshuar me ligjin 16/2024 si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar. Kjo kërkesë për kualifikim,

konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ndryshuar me ligjin 16/2024 dhe nenin 55, pika 4 germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

a) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës sipas modelit të lëshuar nga MPPT: Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhte:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P - 1 - A Punime gërmimi në tokë.

N.P – 7 – A Ujesjellesa, Gazsjellesa, Vajsjellesa, Vepra kullimi dhe vaditje

Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomik cdo antar i grupit duhet te kete secili licensen e mesiperme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 ; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas projekt idese.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas projektit dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

2.3.3.Operatori Ekonomik ofertues duhet qe te kete ne stafin e tij minimalisht nje Inxhinier Ndertimi te stafit teknik. Per kete operatori ekonomik duhet te dorezoje :

- ❖ Certificate “Kordinator i Sigurise ne Kantier” per inxhinierin
- ❖ Diplome
- ❖ Kontrate pune noteriale
- ❖ Cv perkatese

2.3.4Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te deshmojne se disponojne te pakten 5 punetor te thjeshte ne total nga te cilet

- Te pakten **3(tre)** punetor te thjeshte per realizimin me sukses te objektit te prokurimit dhe duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: Kontratë pune e vlefshme, si dhe të figurojë ne listepagesen e muajit te fundit nga data e zhvillimit te tenderit (të firmosura dhe vulosura nga Administrata Tatimore/ në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi)
- **2 shofer** per mjetet eskavator

Për Manovrator/automakiniste/shofer të paraqitet kontrata e punes dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR . Ne rastin kur punonjesit e mesiperm jane te kontraktuar me kontrate pune respektivisht per mjetet e marra me qira , nuk kerkohet te figurojne ne listpagesat e shoqerise.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e sherbimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Nr.	NR. ANALIZE	EMERTIMI I PUNITIT	NJESIA	SASIA	Ore pune	Ore pune total	Dite pune
1	2.25a	Germim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me goma 0.25m3,shkarkimi ne toke	m ³	6 500	0.058	377	47.125
Dite pune ne total per 1 mjet							47.125
Dy mjete e kryejn punen							24
Puntor te thjeshte							5
Drejtues teknik							1

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 2(dy) mjete transporti **ekskavator me goma 0.25m3** në pronësi ose me qira/bashkepunim.

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë**, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.

- Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qerases/ bashkëpunimit.
- **Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë**, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar specifikimeve te administruar ne dosjen e procedures është përcaktuar se nje mjeti te vetem eskavator do ti duheshin 55.2 dite pune per te realizuar sherbimin e pastrimit te kanalit.

Referuar natyres se sherbimit dhe kohes se sezonit veror ku domosdoshmeria e kanalit per sistemin e vaditjes eshte emergjente kerkohen dy mjete me qellim reduktimin e kohes.

Pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj: BASHKELIDHUR NE SPE

Specifikimi i Materialeve:

Zerat e rradhitura në përmbajtjen e ketyre specifikimeve, janë pjesa e detajuar e projektit plus vizatimet si specifikime të tjera të mundshme të kategorive të ndryshme të punimeve.

Standartet e cilësive të cilëve u referohet Përshkrimi I Punimeve për punimet e ndërtimit që do të kryhen dhe pajisjet që duhet të përdoren gjatë zbatimit të punimeve si edhe për mjetet, mallrat dhe aparatet që duhet të bëjnë furnizimin dhe do të instalohen, janë standartet e cilësive sipas ISO ose të Republikës së Shqipërisë.

Përveç certifikatave të cilësive të origjinës, administratori i kontratës mund të kërkojë edhe certifikatat e cilësive dhe të dhënat e performancës teknike të artikujve që do të përdoren në ndërtim.

Standartet e çërdorura në këtë “Specifikim Teknik” nuk janë mbështetur vetëm në vizatimet e dhëna në projekt por edhe në manualët ligjorë dhe librat e tjere këshillues si:

Manual nr.1 “ Analizat teknike të çmimeve “ për prodhimin e materialeve të ndërtimit. Udhëzime dhe kritere .Tiranë-Dhjetor 1992 (Republika e Shqipërisë-Ministria e Ndërtimit).

Manual nr.2 “ Analizat teknike të çmimeve “ për punimet në ndërtimin e ndërtesave. Udhëzime dhe kritere .Tiranë-Dhjetor 1992 (Republika e Shqipërisë-Ministria e Ndërtimit).

Projektimi i betoneve të zakonshme K.T. 37-75 .Tiranë-1980 (Republika e Shqipërisë-Ministria e Ndërtimit I.S.P.Nr.1).

Kushtet teknike të projektimit dhe standartet e Republikës së Shqipërisë (K.T.P.STASH).

Euronorma (EN,HD) dhe eurostandarte sipas rekomandimeve të IEC, CEN/CENELEC ose normave lokale dhe standarteve të veçanta të komunitetit evropian (KE) si CEI (UNI), BS e të tjera.

V.K.M. nr.629 dt.15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre

TE PERGJITHESHME

HYRJE

Qëllimi i përgatitjes së këtij kapitulli, është sqarimi i kërkesave për kontraktorin në lidhje me projektin, ecurinë e punës konform kushteve teknike të zbatimit, kontratës, legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e punonjësve, të ambienteve dhe publikut, si edhe të detyrimeve që duhet të plotësojë kontraktori gjatë zbatimit të punimeve.

Te gjitha vizatimet dhe dokumentat e tjera teknike qe shoqerojne projektin do te jene baze per vleresimin e sasise dhe te cilesise se punimeve qe do te kryhen gjate zbatimit te punimeve per realizimin e ketij proriojekti.

Kontraktori,duhet te shqyrtoje projektin para fillimit te punimeve dhe para lidhjes se kontrates me investitorin duke verifikuar te gjitha sasite,permasat dhe te dhenat teknike si edhe detajet e dhena ne vizatimet perkatese te dokumentacionit teknik qe shoqerojne projektin.

Kontraktori do te marre persiper te gjitha pergjegjesite e kryerjes se punimeve ne sasi dhe cilesi,per materialet qe do te perdoren,volumet e punes dhepajisjet qe do te duhen per kryerjen e kontrates.

Çdo ndryshim apo pershtatje me kushtet e terenit,do te behet vetem ne bashkepunim me projektuesin ose supervizorin e punimeve si edhe me aprovim te investitorit.

1.3 ZEVENDESIMET

Zevendesimet e materialeve te specifikuar ne projekt,do te behen vetem me aprovim te Supervizorit dhe te Investitorit.Keto zevendesime do te behen vetem nese materiali i propozuar eshte me cilesi te njejta ose me te mira se ato qe do te zevendesohen.Kerkesa per zevendesimin e tyre do te shoqerohet me dokumenta qe tregojne cilesine e materialit te propozuar dhe te dhenat teknike te prodhuesit.

1.4 GRAFIKU DHE METODOLOGJIA E PUNIMEVE

Kontraktori,pas shqyrtimit te Projektit dhe gjendjes aktuale ne vend,duhet te pergatit Grafikon e Punimeve dhe Metodologjiine e Punimeve sipas te cilave do te punoje per te plotesuar kerkesat e zbatimit me kohen,sasine dhe cilesine e duhur te punimeve.

Grafiku i Punimeve,dote paraqese aktivitetet kryesore qe do te beje kontraktori per perfundimin e punimeve sipas kontrates.

Ne Grafikon dhe zberthimin e Metodes se Punes duhet te perfshihen keta zera:

-Mobilizimi;Investigimi Topografik dhe Piketimi i Nenobjekteve;Furnizimi,Transporti dhe Magazinimi i Materialeve;Aktivitetet e Punimeve te Tokes;Aktivitetet e Punimeve Hidraulike;Aktiviteti i Punimeve te Beton;Aktiviteti i Punimeve Ndertimore;Aktiviteti per Punimet Elektrike dhe Mekanike;Mbrojtja e punimeve,ambientit dhe publikut;Kontrolli laboratorik,Testimi dhe Kontrolli i cilesise se materialeve;Pergatitja e Librezeve te Masave;Kolaudimi dhe marrja ne dorezim e objektit;Pastrimi i sheshit te ndertimit;Pergatitja e raporteve mujore dhe perfundimtare per punimet e kryera

1.5 KOSTUA E MOBILIZIMIT DHE PUNIMEVE TE PERKOHESHME

Kontraktori i Punimeve,duhet te kuotoje me çmime per njesi te cilat te jene te detajuara.Koston per mobilizimin e ekipit te tij si edhe te makinerive qe do te perdoren per zbatimin e punimeve,do ta perballoje vet kontraktori dhe ne kete kosto do te perfshihen:

-Kostua e sigurimit te transportit dhe lejeve perkatese;Energjia elektrike,lidhjet telefonike dhe furnizimi me uje;Mirembajtja e impianteve te ndertimit,rrugeve dhe ambienteve te punes;Mbrojtja kunder zjarrit;Magazinimi i materialeve,ruajtja e objektit dhe e materialeve qe ndodhen ne te; Kujdesi shendetesor dhe ruajtja e tij

Ne kete kosto do te perfshihet edhe çdo ze tjeter qe shikohet me rendesi nga Kontraktori dhe qe duhet te jepet me çmimin njesi per koston e Mobilizimit.Duhet te kihet parasysh se nuk do te njihet asnje pagese shtese mbi çmimin njesi te dhene nga kontraktori ne Preventivin e objektit.

1.9 PIKETIMI I PUNIMEVE DHE FOTOGRAFIMI I SHESHIT

Kontraktori,me shpenzimet e veta,do te beje ndertimin e piketave dhe modinave sipas kerkesave te kushteve teknike te zbatimitdhe ne perputhje me informacionin e dhene nga investitori.Kontraktori do te jete pergjegjesi i vetem per sakesine dhe perpikmerine e vendosjes se tyre dhe matjeve ne terren.Ai duhet te marre masa per ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre nga demtimet qe mund te ndodhin gjate zbatimit si edhe per zevendesimin e tyre kur demtohen apo nuk gjenden.Kontraktori do te jete pergjegjesi kryesor per kontrollin dhe verifikimin e informacionitbaze qe eshte dhene hde ne asnje rast nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia nese nje informacion i tilleshte i manget,jo autentik apo te mos kete perputhje me gjendjen aktuale.Kontraktori duhet te jape asistencen e tij teknike tek punedhenesi per kontrollin e piketave dhe modinave ne terren.

Kontraktori,gjate gjithë fazes se zbatimit te punimeve duhet te beje ne menyre periodike dhe te vazhdueshme,fotografime apo edhe filmime te punimeve sipas udhezimeve te Supervizorit ne menyre qe te pasqyrohet progresi i punes,cilesia e materialeve te perdorura dhe punimeve te kryera,kushteve ne te

cilat eshte punuar e te tjera.Shpenzimet per fotografimet duhet te parashikohen ne shpenzimet administrative te kontratorit dhe nuk do te njihet ndonje shtese ne lidhje me to.

1.12 TABELA E PUNIMEVE

Kontratori ne fillim te punimeve duhet te pergatite nje table metalike me permasa kryesore 2x1m ku te jepen te dhenat kryesore per emrin e objektit, vleren e tij, fillimin dhe perfundimin e punimeve, punedhenesin, kontratorin, supervizorin e punimeve etj. Forma dhe menyra e paraqitjes do te miratohen nga punedhenesi. Tabela e punimeve duhet te vendoset ne nje vend te dukshem parne shehsit te ndertimit ne bashkepunim me punedhenesin dhe supervizorin.

1.14 LIBREZAT E MASAVE

Kontratori duhet te pergatite vizatime per te gjitha punimet e zbatuara faktikisht ne teren te shoqeruara me libezen e masave, ku te jepen te dhena teknike per sasine dhe permaset e tyre, si dhe parametrat e materialeve te perdorura. Kontratori duhet te pergatise edhe seksionet e profilave sjatesore e terthore te rishikuar si dh e te gjitha detajet te pajisura me shenimet perkatese qe tregojne shtresat e tokes qe hasen gjate punimeve te ndertimit..

Te gjitha punimet e maskuara duhet te pasqyrohen ne librezat e masave dhe do te jene pjese e domosdoshme teknike qe do te dorezohet sebashku me objektin.

Vizatimet dhe librezat e masave do te azhurnohen ne menyre te vazhdueshme dhe do 'ti dorezohen cdo muaj supervizorit per aprovim. Vizatimet e aprovuara do te mbeten prone e punedhenesit dhe so te sherbejne per kolaudimin dhe dorezimin e objektit.

1.15 PASTRIMI PERFUNDIMTAR I SHESHIT TE PUNIMIT

Ne perfundim te punimeve kontratori duhet te heqe me shpenzimet e tij te gjitha impiantet ndertimore, makinerite, pajisjet speciale, matetrialet ndertimore qe kane tepruar, mbeturinat e ndryshme, skelerite etj.

Ne perfundim te punimeve kontratori duhet te beje pastrimin komplet te sheshit te ndertimit dhe ta ktheje ate ne kushte te pranueshme apo me te mira se gjendja e meparshme.

II . PUNIME TOKE

2.1 HYRJE

Qellimi i pergatitjes se ketij kapitulli eshte sqarimi i kerkesave per Kontraktorin ne lidhje me punimet e tokes qe do te kryhen prej tij.Keto kerkesa do te jene ne lidhje me germimin,hapjen e kanaleve,shtresimin e rrugeve,linjave te uji,duke pasur parasysh gjate te gjithë kohes edhe makinerite qe do te perdoren per keto punime si edhe kushtet teknike te zbatimit,legjislacionin ne fuqi per mbrojtjen e punonjesve,te ambientit dhe publikut si edhe detyrimet qe duhet te plotesoje Kontraktori gjate zbatimit te punimeve.

2.3 PASTRIMI I SHESHIT

Ne te gjitha sheshet ku do te germohet,do te behet pastrimi nga shkuret,bimet,ferrat,rrenjet,plehrat dhe materialet e tjera siperfaqesore.Te gjitha keto materiale do te spostohen dhe do te largohen ne menyre te tille qe te jete e pelqyeshme nga punedhenesi dhe pushteti lokal.Te gjitha pemet dhe shkuret qe jane percaktuar te mbeten ne vend,do te mbrohen dhe do te ruhen sipas kushteve teknike te zbatimit te aprovuara edhe nga supervizori i punimeve.

Te gjitha strukturat ekzistuese te identifikuara per tu prishur,do te largohen sipas udhezimeve te supervizorit dhe punedhenesi.Kjo do te perfshije edhe struktura qe ne momentin e lidhjes se

kontrates,jane te pa identifikuara pasi jane nen siperfaqen e tokes(te pa dukshme).Gjate punes,persa u permend me lart (struktura nen siperfaqen e tokes te pa dukshme)duhet te kuptojme edhe spostimin e themeleve te ndertimeve qe mund te ndeshen gjate punes.

Kontratori,duhet te narre te gjitha masat e nevojshme per mbrojtjen e vijave te ujit,rrethimevedhe sherbimeve te tjera ekzistuese qe do te mbeten edhe pas perfundimit te punimeve ne veper.

2.4 GERMIME PER STRUKTURAT

Germimet,do te behen ne permasat dhe nivelin qe percaktohet ne vizatimet ose ne instruksionet e dhena me shkrim nga supervizori.Kur niveli i bazamentit eshte i arritur.Supervizori dote inspektoje dheun e tabanit dhe krahasimisht me projektin,do te jape udhezimet per germim te metejshem nese ai e konsideron te nevojshme.

Germimi do te behet ne menyre te tille qe te siguroj qe shtrirja e bazamentit sipas projektit te qendroje ne nje bazament solid dhe kushte normale per vazhdimin e punimeve te shtresave rrafshuese mbi te cilat do te fillojne strukturat e betoneve.

Germimet do te quhen te mbaruara dhe te gateshme per te filluar shtresat,vetem me miratimin e Supervizorit me procesverbalin perkates qofte kjo edhe me thirjen e projektuesit per nje konsolte apo miratim i krahasuar me ate cka eshte hedhur ne fletet e vizatimit.

2.5 MIREMBAJTJA E PUNIMEVE TE GERMIMIT

Te gjitha punimet e gerimit ,do te mirembahen ne kohen qe ato jane te hapura dhe te ekspozuara si gjate dites ashtu edhe gjate nates.Pengesa te mjaftueshme,drita paralajmeruese,shenja si edhe mjete te ngjashme per kete qellim,do te sigurohen nga Kontratori.Kontratori do te jete pergjegjes per ndonje demtim personi ose pronesie per shkak te neglizhences se tij ose te mos marrjes se masave te duhura te Sigurimit Teknik.

2.6 PERFORCIMI DHE MBROJTJA E PUNIMEVE TE GERMIMIT

Nese germimet e zakoneshme nuk jane te mundura te kryhen sipas atyre te parashikuara ne vizatimet perkatese te projektit,gjate germimeve duhet te vendosen struktura mbajtese per te parandaluar demtimet dhe vonesat ne pune si edhe per te krijuar kushte te sigurta mbrojtese te personelit punonjes gjate kohes se kryerjes se punimeve me miratim te Supervizorit por pa kerkuar shtesa ne preventivin e miratuar gjate hartimit te kontrates se siper marrjes nga ana e Kontratuesit me Kontratorin. Strukturat mbrojtese,do te hiqen sipas avancimit te punimeve dhe ne menyre te tille qe te parandalojne demtimin e punimeve te perfunduara si edhe te strukturave apo pasurive qe duhet te ruhen dhe te mbeten te pa prekura.Kur keto struktura te hiqen,te gjitha boshlleqet qe mbeten nga heqja e tyre,duhet te mbushen me kujdes dhe me material te zgjedhur dhe te ngjeshur me shresa jo me te trasha se 20cm.

Kostua e perforcimeve dhe e veshjeve gjate germimeve,eshte e perfshire ne preventiv tek zeri i germimeve dhe tek zeri i Pilotave.

2.8 HEQJA E UJRAVE GJATE PUNIMEVE TE GERMIMIT

Si pjese e punes ne zerat e germimit dhe pa kosto shtese,Kontratori duhet te ndertoje te gjitha drenazhet e duhura dhe te realizoje kullimin me kanale,me pompim ose me kova si edhe te gjitha punimet e tjera te nevojshme per te mbajtur pjeset e germuara te pastra nga influenza e ujrave,deri ne perfundim te punimeve pa deme.Kontratori duhet te siguroje pa shtesa ne preventivin me te cilin lidhet kontrata,te gjitha pajisjet e duhura hidraulike dhe elektrike te nevojshme per zbatimin e siper marrjes.

Gjate kryerjes se punimeve,kohezgjatja shtrihet ne muajt e pranveres,veres,vjeshtes dhe dimrit prandaj nga ana e Kontratorit duhet te merren masat e nevojshme per perballimin e permbytjeve te mundeshme nga reshjet pasi demet qe mund te shkaktojne keto permbytje do te perballohen me shpenzime shtese te Kontratorit pa renduar preventivin e objektit apo fondin rezerve te tij,pra keto punime nuk do te situacionohen dhe rrjedhimisht,nuk do te financohen.

2.10 HEQJA E MATERIALEVE TE TEPERTA GJATE GERMIMEVE

I gjithë materiali i tepert i germuar,do te largohet ne vendet e aprovuara nga Punedhenesi ne bashkepunim me pushtetin vendor.Kur do te jete e nevojshme te transportohet materiali mbi rruget ose vendet e shtruara,me pare duhet te sigurohet ky material nga derdhja ne rruge ose jashte vendeve te caktuara.

2.11 MATJA E VOLUMEVE TE GERMIMIT

Te gjitha zerat e germimeve do te maten ne volum.Matjet e volumeve te germimit do te bazohen ne dimensione te marra ne fakt pas kryerjes se tyre te shprehura ne vizatimet perkatese ne te cilat percaktohen permasat e ketyre germimeve.

Çdo germim pertej limiteve te percaktuara ne vizatimet e dhena ne projekt nuk do te paguhet nese nuk eshte miratuar me pare nga Supervizori dhe Investitori.Nese volumi eshte me pak se ai i volumeve te llogaritura nga vizatimet, pagesa do te behet vetem per volumet qe dalin nga matjet faktike.

2.12 MATJA E VOLUMEVE TE MATERIALEVE TE SHTRESAVE

Te gjitha zerat per mbushje apo mbulim,do te maten ne volum.Matja e volumeve do te bazohet ne dimensionet e marra ne vizatimet ne te cilat percaktohen permasat e mbushjeve dhe te mbulimit.Çdo mbushje pertej limiteve te percaktuara ne keto limite,nuk do te paguhet,nese nuk percaktohet me pare me shkrim nga Supervizori dhe te miratohen nga Kontratuesi.Nese volumi eshte me pak se ai i volumeve te llogaritura nga vizatimet, pagesa do te behet vetem per volumet qe dalin nga matjet faktike.

ANALIZA E ÇMIMIT NJESI TE PUNIMEVE TE GERMIMIT

Çmimi njesi i zerave te punes per germimet perfshin germimin ne te gjithë gjerësine dhe thellesine ,germimin me çdo mjet qe te jete i nevojshem,duke perfshire germimet me dore,nen apo mbi nivelin e ujrave nentokesore ose ne nivelin e ujrave siperfaqesor,perfshi edhe perzierjet e dherave me ujrë.Si baze per analizen e çmimeve eshte marre - V.K.M. nr.1359 dt.10.10.2008 “Per miratimin e manualeve teknike te çmimeve te punimeve te ndertimit dhe analizave teknike te tyre.

ANALIZA E ÇMIMIT NJESI TE MBUSHJEVE DHE NGJESHJEVE

Çmimi njesi per mbushjen ,rrafshimin apo ngjeshjen e dherave, mbulon materialin mbushes,ngarkimin.shkarkimin.transportin,rrafshimin ne shtresa,ngjeshjen ne shtresa,lagjen e shtresave kur ajo eshte e nevojshme,provat e te gjitha materialeve,makinerite,fuqine punetore dhe çdo aktivitet tjeter te pershkruar ne preventiv dhe qe jane te nevojshme dhe te domosdoshme per realizimin e punimeve sipas kerkesave te projektit.Kudo qe te jete e mundur,materiali mbushes dhe mbulues do te jete nga materiali i germuar.Vetem kur materiali i germuar nuk do te jete i pershtatshem apo i mjaftueshem,materiali mbushes do te merret nga jashte kantjerit me aprovimin e Supervizorit pa shtese ne preventivin e kontrates.

Çdo ndryshim i volumit të punimeve të mbushjeve dhe mbulimit përtej limiteve të treguara në vizatimet e projektit nuk do të financohen përveç rasteve kur miratohen nga Supervizori dhe investitori me shkrim.

Si bazë për analizën e çmimeve është marrë - V.K.M. nr.1359 dt.10.10.2008 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre.

III. BETONET

TE PERGJITHSHME

Qëllimi i punës që përfshin ky kapitull është zbatimi i procesit të betonit konform standarteve, kushteve teknike dhe kërkesave të projektit jgate ndërtimit ose rehabilitimit të linjave të Ujesjellesit, Kanalizimeve dhe Punimeve në Rezervuarë. Kryerja e këtij procesi duhet të bëhet me makineri perkatese (perzierje betoni, vibrator mekanik, etj) veglat e punës, materiale dhe pajisje të tjera speciale (pompa, pajisje topografike, etj) që janë të domosdoshme për përfundimin në sasinë dhe cilësinë e duhur të këtij procesi.

Në fillim të Kontrates, Kontraktori duhet të paraqesë tek Supervizori propozimin e tij për organizimin e aktiviteteve të betonimit në shesh i cili duhet të përmbajë: Vëndosjen dhe shtrirjen e pajisjeve të prodhimit të betonit

Metodat e propozuara për organizimin e pajisjeve të prodhimit të betonit

Procedurat e kontrollit të cilësive të betonit dhe materialeve të betonit.

Transporti dhe hedhja e betonit.

Detaje të punës së blerjes së kallopeve duke përfshirë kohën e heqjes së kallopeve dhe procesurat për mbështetjen e perkohshme të trareve dhe soletave që do të vëndosen.

KONTROLLI I CILËSISË

Kontraktori duhet të ketë në stafin e tij një inxhinier ndërtimi të kualifikuar, të specializuar, me licencën perkatese dhe me eksperiencë, i cili do të jetë përgjegjës për kontrollin e cilësive të të gjithë betoneve.

Materialet dhe mjështeria e përdorur në punimet e betonit duhet të jenë e një cilësie sa më të lartë që të jetë e mundur.

Kontrolli i cilësive do të bëhet konform Kushteve teknike dhe standarteve perkatese në prezencë të Inxhinierit dhe Supervizorit të Punimeve të cilët do të jenë edhe përgjegjës për cilësinë e betoneve të hedhura në veper.

PUNA E PERGATITUR DHE INSPEKTIMI

Përpara se të kryhet procesi i përgatitjes së llacit ose të betonit, zona brenda armaturave duhet të jetë e pastruar shumë mirë me ujë ose me ajër të komprimuar.

Asnjë proces betonimi nuk duhet të kryhet derisa Supervizori të ketë inspektuar dhe aprovuar (nese është e mundur) germimin, masat e marra për mbrojtjen nga kushtet atmosferike, masat për shpërndarjen e ujit për freskim dhe stazionim të betonit, fugat ndërtimore dhe fiksimin e fundeve, armimin si dhe të gjitha materialet e tjera për betonimin dhe masa të tjera në përgjithsi.

MATERIALET

Çimento

Nje nder materialet me te qendrueshme qe perdoren per betonet dhe qe duhet ti nenshtrohen kontrollit teknik te Supervizorit eshte cimento. Gjate betonimeve mund te perdoren dy lloje cimentoje (me perjashtim te rasteve kur ka kerkesa specifike nga projektuesi) si me poshte:

Çimento Portland e zakonshme do te perdoret sipas standarteve te ISO ose ASTM C-150 , tipi II ose Tipi V. Kjo lloj cimento do te perdoret per betonet qe jane ne prezence te ujrave, ujrave te zeza , tubave te gazit apo ujrave nentokesore.

Çdo lloj cimento e ngurtesuar apo e demtuar nuk duhet te perdoret.

Çdo dergese e cimentos duhet te jete e shoqeruar me certifikate cilesie dhe flete analizat perkatese te fabrikes prodhuese.

Çimento perftuar nga pastrimi i thaseve te cimentos ose nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret.

Supervizori ka te drejte te kerkoje ritestimin e cimentos kur ka dyshime mbi cilesine e saj apo gjendjen aktuale.

Inerttet

Inerttet per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH -512 – 78 ose ne perputhje me ASTM C 33.

Ato duhet te jene te paster , te forte, te qendrueshme, dhe nuk duhet te permbajne lende organike ose masa te reja te demshme qe veprojne kunder fortesise dhe qendrueshmerise se betonit apo te betonarmese.

Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohen nga burimet e njohura dhe te licensuara qe sigurojne rezultate te kenaqshme per te gjitha llojet e betoneve.

Inerttet e perdorura do te jene te imta dhe te trasha. Ato do te perdoren se bashku ne betonet sipas nje raporti te dhene nga Kushtet Teknike perkatese dhe me aprovimin e Supervizorit te Punimeve. Me poshte po japim detaje per secilen prej llojeve te inerteve:

Inerttet e imeta

Inerttet e imeta per kategorite e betonit A, B, C (Betone me marke M-100, M-200 , M-300) konform STASH-512-78 do te jene prej rere natyrale , gure te shoshitur ose materiale te tjera inerte me te njejtat karakteristika apo kombinim te tyre. E gjitha kjo duhet te jete e pastruar shume mire , pa masa te mpiksura, cifla te buta e te vecanta , vajra distilimi , alkali , lende organike, argjile dhe sasi te substancave te tjera demtuese.

Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave te tjera demtuese eshte 5%. Materialet e marra nga gurre te papaershtatshme per inerte te trasha nuk duhet te perdoren per inerte te imta.

Shkalla e shperndarjes per inerttet e imta te specifikuara si me larte, duhet te jene brenda kufijve te meposhtem:

Masa e sites	Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)
10.0 mm	100
5.0 mm	90-100
2.4 mm	60-100
1.2 mm	30-100
0.6 mm	15-100
0.3 mm	5-70
0.15 mm	0-15

Inerttet e imta per kategorine D te betonit duhet te jene te nje cilesie te mire nga rera e brigjeve. Ajo duhet te jete e pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga me e holla e deri tek me e trasha, pa

copeza,nga argjila,plehra,etj.Ato nuk kduhet te permbajne me shume se 10% te materialit me te holle se 0.1 mm te hapesires ne rrete dhe jo me shume se 5% te pjeses se mbetur ne 2.4 mm site.

Inerttet e trasha

Inerttet e trasha per kategorine A,B dhe C do te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjerre ose nje kombinim i tyre me nje mase jo me shume se 20 mm do te jene te paster, te forte ,te qendrueshem,kubik dhe te formuar mire ,pa lende te buta apo te thermueshme ose copeza te holla te strgjatura,alkali ,lende organike ose masa apo substance te tjera te demshme.Lendet demtuese ne inerttet e trasha nuk duhet te kalojne me shume se 3%.Klasifikimi per inerttet e trasha te specifikuar sa me siper duhet te jene brenda kufijve te me poshtem:

Masa e sites	Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)
50.0 mm	100
37.5 mm	0-100
20.0 mm	35-70
10.0 mm	10-40
0.5 mm	0-5

Inerttet e trasha per kategorine D te betonit,duhet te jene te nje cilesie te mire nga tulla te thyera te prodhuara prej tullave te cilesise se pare.Ato nuk duhet te permbajne mbeturina bimore ,rere ose materiale te huaja apo mbeturina te tjera.

Raportet e trasha dhe te imeta te inerteve

Raporti me i pershtatshem i volumit te inerteve te trasha ne volumen inerteve te imta duhet te vendoset nga prova e ngjeshjes se kubikeve te betonit, por Supervizori mund te urdheroje qe keto raporte tendryshojne lehtesisht sipas klasifikimit te inerteve ose sipas peshes nese do te jete e nevojshme, ne menyre qe te prodhohen klasifikimet e duhura ne perzierjen e inerteve te trasha dhe te imta.

Kontraktori duhet te beje disa prova ne kubiket e marre si kampione dhe te shenoje inerttet dhe funksionimin e tyre, perzierjen e betonit ne fillim te punes dhe kur ka ndonje ndryshim ne inerttet e imta apo te trasha ose ne burimin e tyre te furnizimit.

Keta kubike duhet te testohen ne laborator ne kushte te njejta. Kubiket duhet te testohen nga 7,14 deri ne 28 dite.

Nga rezultatet e ketyre provave, Supervizori i punes mund te vendose per raportet e trashesise se inerteve te imta qe duhet te perdoren per cdo perzierj te mevonshme gjate zhvillimit te punes derisa te kete ndonje ndryshim ne inerte.

c. Uji per beton

Uji i perdorur per beton duhet te jete i paster, i fresket dhe pa balte, papasterti organike vegjetale dhe pa kripra dhe substance te tjera qe nderhyjne ose demtojne forcen apo durueshmerine e betonit. Uji duhet te sigurohet mundesisht nga furnizirnet publike dhe mund te merret nga burime te tjera vetem nese aprovet nga Supervizori i punimeve. Nuk duhet te perdoret uje nga germimet, kullimet siperfaqesore apo kanalet e vaditjes. Vetem uje i aprovuar nga ana cilesore per larjen e pastrirnin e armaturave, kujdesin e betonit si dhe per qellime te ngjashme.

3.5. METODAT DHE KERKESAT PER PERZIERJEN E BETONEVE

Betoni duhet te perzihet me perziersa mekanike te miratuara qe me pare. Perziersi, hinka dhe pjesa perpunuese e tij duhet te jene te mbrojtura rrga shiu dhe nga era.

Inertet dhe pimento duhet te perzihen se bashku para se te shtohet uje derisa perzierja te fitoje ngjyren dhe fortesine e duhur.

Kerkesat per perzierjen e betonit duhet te konsistojne ne ndarjen proporcionale dhe perzierjen per fortesite e meposhtme kur behen testet e kubikeve:

Klasa e betonit	Fortesiane shtypje ne N/mm^2	
	7 dite	28 dite
Klasa A & A (M100) (s)	17.0	25.5
Klasa B & B (M200) (s)	14.0	21.0
Klasa C & C (M250) (s)	6.5	10.0
Klasa D & D (M300) (s)	me pelqimin e supervizorit	

Shenim: shenja s = (çimento sulfate e rezistueshme)

Raporti uje - çimento eshte raport i peshes se çimentos ne te. Permbajtja e ujit ne te duhet te jete efikase per te prodhuar nje perzierje te punueshme te fortesise se specifikuar, por permbajtja totale e ujit duhet te percaktohet nga tabela e meposhteme:

Klasa e betonit	* Max. i ujit te lire/ raporti çimento
Klasa A & A (M100) (s)	0,50
Klasa B & B (M200) (s)	0,60
Klasa C & C (M250) (s)	0,65
Klasa D & D (M300) (s)	me pelqimin e supervizorit

3.6. PROVA E FORTESISE SE BETONIT

Kontraktori duhet te siguroje per qellimet e provave nje set 3 kubikesh per cdo strukture betoni perfshire derdhje betoni nga $1-15m^3$. Per derdhje betoru me shume se $15m^3$ duhet te sigurohet nje set shtese 3 kubikesh. Nese mesatarja e proves se fortesise se kampionit per cdo porcion te punes bie poshte minimumit te lejueshem te fortesise se specifikuar, Supervizori do te udhezoje nje ndryshim ne raportet ose permbajtjen e ujit ne beton ose te dyja ne menyre qe Punedhenesi te mos kete kosto shtese.

Kontraktori duhet tepercaktoje te gjitha kampionet qekane te bejne me raportet e betonimit prej nga ku jane marre. Nese rezultatet e testeve te fortesise pas kontrollit tregojne se betoni i perftuar nuk ploteson kerkesat e specifikuara ose kur ka prova te tjera qe tregojne se cilesia e betonit eshte nen nivelin e kerkesave te specifikuara, kampioni do te refuzohet nga Supervizori i punimeve dhe Kontraktori do ta rivendose masen e kthyer mbrapsht me shpenzimet e veta. Kontraktori duhet te mbuloje me shpenzimet e vet ate gjitha provat qe do te behen ne laborator qe eshte aprovuar nga Punedhenesi.

3.8. HEDHJA DHE NGJESHJA E BETONEVE

Kontraktori te ndjeke nga afer progresin e hedjes dhe ngjeshjes se betonit si njepuneme rendesi te madhe, objekti i te dies duhet te jete prodhimi i nje betoni te papershkueshem nga uji me nje densitet dhe fortesi maksimale.

Pasi te jete perziere, betoni duhet te transportohet ne vendin e punes sa me shpejt te jete e mundur, i ngjeshur mire deri sa te krijoje siperfaqe te lemuara, pa vrima dhe pa xhepa ajri. Armatura duhet te jete e hapur ne menyre qe te lejoje daljen e bulezave te ajrit dhe betoni duhet te vibrohet me gdo kusht me mjete vibruese per ta bere sa me te dendur dhe aty ku eshte me e nevojshme. Mjetet vibruese duhet te prodhojne vibrime jo me pak se 5000 cikle ne minute. Vibratoret duhet te vsndosen vertikalisht ne beton dhe te terhiqen gradualisht kur fluckat e ajrit nuk dalin me ne siperfaqe. Te gjitha vendet e hedhjes dhe ngjeshjes se betonit duhet te mbahen ne mbikqyrje te vazhdueshme nga pjestaret perkateste ekipit te punes.

Betoni duhet të hidhet sa është i fresket dhe para se të ketë fituar qëndrueshmërinë fillestare por gjithmone jo më vonë se 30 minuta nga perzierja. Kur hedhja e betonit nderpritet, betoni duhet të lejohet të formojë skaje apo ane por duhet të ndalohej dhe të forcohet mirë në një ndalesë të ndertuar dhe të formuar posaçërisht për të krijuar një bashkësi konstruktiv efikas që është në përgjithësi drejt armatimit kryesor. Para se të hidhet betoni tjetër, sipërfaqet e të gjitha fugave duhet të ndahen, të kontrollohen, të pastrohen me furçe metalike dhe të lahen.

Para se betoni të hidhet në një sipërfaqe të germuar, ky germim duhet të jetë i forcuar dhe pa ujë të rrjedhshëm apo të ndenjtur, vaj apo lende të tjera të demshme.

3.9. BETONIMI NE KOHE TE NXEHTE DHE KUJDESI PER BETONET

Kontraktori duhet të tregojë kujdes gjatë motit të nxehjeve për të ndaluar çarjen ose plasaritjen e betonit. Do të ishte mirë që betoni të hidhet në mëngjes ose natën vonë. Kallepet duhet të mbulohet nga ekspozimi direkt në diell si para vendosjes së betonit ashtu edhe gjatë hedhjes ose vendosjes së tyre. Kujdesi për të gjitha betonet duhet të ndiqet si më poshtë:

Sipërfaqe betoni horizontale do të mbahet e lagët vazhdimisht për të paktën 7 ditë pas hedhjes. Ato do të mbulohen me materiale ujembajtëse si thasë kerpi, pelhure ose menyra të tjera të aprovuara nga Supervizori.

Sipërfaqe betoni vertikale do të kujdesen fillimisht duke lene armaturat në vend pa levizur dhe duke e mbajtur vazhdimisht të lagët për të paktën 7 ditë pas hedhjes. Ato do të mbulohen me materiale ujembajtëse si thasë kerpi, pelhure.

3.10. FORCIMI I BETONIT

Me perfundimin e germimit dhe aty ku jepet në vizatim ose urdherohet nga Supervizori, një shtresë forcuese betoni e kategorisë D me trashësi jo më pak se 75cm e trashë do të vendoset për të parandaluar shperberjen e masës dhe për të formuar një sipërfaqe të pastër pune për strukturën.

3.11. HEKURI PER BETONET

Shufrat e armimit duhet të kthehen sipas masave dhe dimensioneve të vizatimeve dhe në përputhje të plote me rregulloren e rishikuar të ASTM, shenimi A - 165 me titullin "Specifikimet për shufrat e hekurit për betonarme". Ato duhet të perkulen në përputhje me vizatimet e ASTM A-305, çelik s-500 me sigma të rrjedhshmerise $\geq 2500 \text{ kg/cm}^2$. Hekuri i armuar duhet të jetë pa njolla, ndryshk, vajra, bojra, graso, etj. që mund të demtojnë lidhjen midis betonit dhe armimit, ose që mund të shkaktojnë korrozionin e armimit.

Shufrat duhet të perkulen gjithmone në të ftohtë. Shufrat e perkulura jo siç duhet do të perdoren vetëm nëse mjetet e perdorura të mos demtojnë materialin. Rrezja e brendshme e perkuljeve nuk duhet të jetë më e vogël se dyfishi i diametrit të shufrave për hekur të butë dhe trefish i diametrit të shufrave për hekur shumë elastik.

Armimi duhet të behet me shumë kujdes dhe të mbahet nga paisje speciale të miratuara në skica. Kordonat lidhen dhe të tjeret si keto duhet të lidhen fort me shufrat dhe përveç kësaj duhet të jenë të lidhura dhe me tel.

Menjëherë para betonit, armimi duhet të kontrollohet për saktësi vendosje dhe pastërtie dhe të korigjohet nëse është e nevojshme. Gjatesia e nyjeve bashkuese duhet të jetë jo më pak se 40 herë e diametrit të shufres.

Prerja, perkulja dhe vendosja e armimit duhet të jetë pjesë e punës brenda crnimit njësi të armimit të hekurit të furnizuar dhe venë në punë.

3.12. KALLEPET (ARMATURAT)

Armatura ose kallepet duhet të jenë në përshtatje me profilet, linjat dhe dimensionet e betonimit të percaktuara në skicat dhe vizatimet për fiksuara apo të mbështetura me pyka apo mjete të ngjashme

per te lejuar qe ngarkimi te jete i lehte dhe format te levizen pa demtime dhe pa goditje ne vendin e punes. Furnizimi, fiksimi dhe levizja e kallepeve duhet te jete pjese e punes brenda cmimit njesi te dhene per kategori te ndryshme te betoneve e te furnizuar dhe te hedhur ne veper.

Kallepet duhet te ndertohen me vija qe mbyllenlehtesisht per largimin e ujit, materialeve te demshme dhe per qellime inspektimi si dhe me lidhesa per te lehtesuar shkeputjen pa demtuar betonin. Te gjitha mbeshleteset vertikale duhet te jene te vendosura ne menyre te tille qe mund te ulen dhe kallepi te shkeputet lehte me goditje apo shkeputje. Kallepet per trare duhet te montohen me nje pjese ngrites 6 mm per cdo 3m shtrirje.

Metoda e fiksimit te kallepit faqe te ekspozuara te betonit nuk duhet te perfshijne ndonje lloj fiksimi ne beton ne menyre qe te kemi siperfaqe te sheshta betoni. Asnje bullon, tel nuk duhet te perdoret ne betonim i cili do te jete i papershkueshem nga uji.

Nje tolerance prej 3mm ne rritje ne nivel do te lejohet ne ngritjen e kallepit i cili duhet te jete i forte, rigjide perkunder betoneve te laget, vibrimeve dhe ngarkesave te ndertimit dhe duhet te mbetet ne pershtatje te plote me skicen dhe nivelin e pranuar perpara betonit.

Te gjitha qoshet e jashtme te betonit qe nuk jane vendosur pergjithmone ne toke duhet tu jepet 18 mm kanal, perve? aty ku trgohet ndryshe ne vizatimet.

Armaturat duhet te jene prej druri ose metali por gjithmone ato duhet te jene rigjide dhe te forta per ti qendruar forces se betonit dhe cdo ngarkese konstruktive. Ne cdo rast ato duhet te jene te mberthyera ne menyre gjatesore dhe terthore.

Pjesa e brendshme e te gjitha armaturave duhet te lyhet me vaj lini, nafte bruto ose sapun cdo here qe ato fiksohen ne menyre qe te ndalohet ngjitja e betonit tek armature.

Armatura duhet te goditet pa tronditur, vibruar ose tronditur betonin. Armatura qe do te riperdoret duhet te riparohet dhe pastrohet perpara se te rivendoset ne objekt. Siperfaqet e brendshme duhet te pastrohen komplet para vendosjes se betonit. Ne rast se armature eshte prej druri siperfaqja e brendshme duhet te laget pikerisht para se te hidhet betoni

Teheqjet, konet, paisjet larese ose mekanizma te tjere qe lene vrime ne siperfaqen e betonit me $d > 20\text{mm}$ nuk do te lihen brenda formave. Armatura nuk duhet te levizet derisa betoni te arrije fortesine e duhur per te siguruar nje qendrueshmeri te struktures dhe per te mbajtur ngarkesen ne keputje dhe cdo ngarkese tjeter konstruktive qe mund te veproje ne te.

Betoni duhet te jete mjaft i forte dhe te parandalohet demtimi i siperfaqeve nepermjet perdorimit te veglave ne hqjen e formave. Armatura duhet te hiqet vetem me lejen e Supervizorit te punimeve ne cdo rast. Kontraktori eshte pergjegjes per ndonje demtim per punen qe lidhet me to. Me poshte po japim nje guide orientuse persa i perket kohes se heqjes se armaturave prej kallepeve te ndryshme.

Ne lidhje me raportet e materialeve qe duhet te perdoren per betonet e ketyre punimeve te ndertimit dhe referuar zerave specifike jane te vlefshme standartet K.T. 37-75 te Republikes se Shqiperise per 1 m^3 volum beton me cemento te zakonshme Portland.

Me poshte po japim disa te dhena baze qe duhet te kihen parasysh gjate ketyre punimeve:

2.6, cemento 400 kg 260 m^3 0.44, granil m^3 0.7, uje m^3 0.18.

• Beton Marka 200 me inerte konsistenca 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere lare me modul 2.6, cemento 400 kg 300 m^3 0.43, granil m^3 0.69, uje m^3 0.18.

• Beton Marka 250 me inerte konsistenca 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere lare me modul

3.14. FUGAT DHE BASHKIMET STRUKTURE

Betonet e armuara duhet të kenë fuga strukturore në mënyrë që të rregullojnë levizjen gjatë ndërtimit dhe operimit për shkak të ngarkesave dhe vendosjeve të ndryshme, bymimeve, tkurjeve dhe rreshqitjeve relative.

Pengesat e ujit (water stopet) duhet të jenë PVC ose gome me një minimum gjerësie prej 20mm. Bashkirnet në objekt të water stopëve PVC do të behet në të njëjtë. Water stopet fleksible do të mbështeten plotësisht të larguara nga perforcime dhe lidhje të fiksuara me të pakten 12mm dhe duke bërë kujdes se mos demtohen.

Bashkirnet konstruktive duhet të vendosen atje ku forcat prerëse ose tensioned janë në minimum ose ku ato do të ndikojnë të pakten në cilësitë e kerkuara ose në pamjen e jashtme të punimeve. Lartësia e ngritjes nuk duhet të kalojë 1,5m.

Linjat e bashkimit duhet të jenë të pastra dhe të rregullta dhe aty ku është e mundur të pershtaten për tu përputhur me tiparet e punës së mbaruar. Në betonet e parapërgatitur nuk do të ketë bashkime konstruktive.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Sherbimi i kryer duhet të jetë sipas zerave të preventivit brenda afatit kohor të përcaktuar në grafikun e punimeve Sherbimi do të quhet i kryer pas verifikimit në terren nga Ak .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT :